



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e premte, në datën 05 shkurt 2021, në mjediset e AMA-s, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Gentian	SALA	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Agron	GJEKMARKAJ	Anëtar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar

AMA pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. Miratimin e udhëzimit “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për monitorimin e mbulimit nga ofruesit e shërbimit mediatik audio/audioviziv (OSHMA) të fushatës zgjedhore”. **(Vendimi nr. 11, datë 05.02.2021)**
2. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “Abissnet” sh.a., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, online mbështetur në rrjet IP (OTT) “Abissnet”. **(Vendimi nr. 12, datë 05.02.2021)**
3. Pajisjen e shoqërisë “F.K.T” sh.p.k., me licencë shërbimi programi audioviziv “Tv Apollon”, për Qarkun Vlorë”. **(Vendimi nr. 13, datë 05.02.2021)**
4. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Johaniteri” sh.p.k., dhe ndryshimin e emrit të shërbimit programor nga “Tv Johaniteri” në “MCN TV”. **(Vendimi nr. 14, datë 05.02.2021)**
5. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “Fastnet Albania” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “TV kabllor Fastnet”, për reduktimin e zonës së ofrimit të shërbimit duke hequr dorë nga zona “*Njësia administrative Pogradec*”. **(Vendimi nr. 15, datë 05.02.2021)**
6. Pranimin e ankimit administrativ të paraqitur nga shoqëria “RTV-REAL” sh.p.k., duke vendosur shfuqizimin e vendimit të AMA-s nr. 55, datë 05.08.2020 “Për heqjen e licencës së shoqërisë “RTV-REAL” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat “TV RE.AL” **(Vendimi nr. 16, datë 05.02.2021)**
7. Pranimin e kërkesës së subjektit, shoqërisë “Dynamicsound” sh.p.k., për ndryshimin e kushteve teknike, dhënien në përdorim të frekuencës 95.2 MHZ dhe saktësimin e zonës së licencimit të subjektit në “*Qarqet Tiranë, Durrës, Fier dhe Vlorë*”. **(Vendimi nr. 17, datë 05.02.2021)**
8. Rinovimin e licencës së shoqërisë “Radio Euro Star Music” sh.p.k., për subjektin audio privat vendor “Radio Eurostar” dhe saktësimin e zonës së licencimit në “*Bashkitë Tiranë, Vorë, Kamëz, Shijak, Durrës, Elbasan, Cërrik dhe Belsh*”. **(Vendimi nr. 18, datë 05.02.2021)**

9. Dhënien e autorizimit, shoqërisë “APT CABLE” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, online mbështetur në rrjet IP (OTT). **(Vendimi nr. 19, datë 05.02.2021)**
10. Çeljen e garës për lëshimin e 1 (një) licence lokale të shërbimit programi audioviziv ne qarqet Fier dhe Vlorë. **(Vendimi nr. 20, datë 05.02.2021)**

Gjatë zhvillimit të mbledhjes, 3 anëtarë të AMA-s e ndërprejnë mbledhjen dhe projektvendimi “Për ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Channel One” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat “TV Ora Neës”, për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm ligjor për vijimin e mbledhjes së AMA-s (4 anëtarë), shtyhet për në mbledhjen e radhës.

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 05.02.2021